



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM
Nr. 242, datë 25.11.2019

**PËR EMËRIMIN SI PROKUROR NË PROKURORINË E POSAÇME
KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR**

Bazuar në nenin 148/dh të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 48/1, 163/2, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nenin 4, nenin 12 të Ligjit nr.95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, Këshilli i Lartë i Prokurorisë pasi ka verifikuar plotësimin e të gjitha kushteve dhe kriterëve të parashikuar në ligjin nr.95/2016 dhe në referencë të vendimit të tij, nr.137 datë 16.07.2019 “Për miratimin e listës me renditjen e kandidatëve për prokurorë në Prokurorinë e Posaçme”,

V E N D O S I:

1. Të emërojë si prokuror në Prokurorinë e Posaçme Z. Arben Kraja për një mandat 9 (nëntë) vjeçar pa të drejtë riemërimi.
2. Të njoftohen me këtë vendim Prokurori i Përgjithshëm dhe prokurori Arben Kraja.
3. Ky vendim hyn në fuqi më datën 19 dhjetor 2019 dhe botohet ne faqen zyrtare të Këshillit.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

**KRYETARI
GENT IBRAHIMI**

**ZV/KRYETAR
ALFRED BALLA**

**ANËTAR
KOSTAQ BELURI**

**ANËTAR
BUJAR SHESHI**

**ANËTAR
NURIHAN SEITI**

**ANËTAR
SANDËR BEÇI**

**ANËTAR
VATË STAKA**

**ANËTAR
TARTAR BAZAJ**

**ANËTAR
ARBEN DOLLAPAJ**

**ANËTAR
ESMERALDA CAMI (Aeshi)**

**ANËTAR
BESNIK CANI**